



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. ____/____Prot.

Fier, më ____08.2024

Lënda: Formulari i njoftimit të fituesit ne perfundim te afateve te ankimimit për proceduren me objekt “Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Bulevardi “Jakov Xoxa”, nga rrethrotullimi Ura Sheq – rrethrotullimi i Sharrës, Fier”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkise Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË
(për botim)

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data: 05.08.2024

Drejtuar: Bashkimit te operatoreve ekonomike **NGRACAN 1934 shpk & GLAVENICA shpk**

Adresa: “Fier Fier FIER Lagjja "Sheq i Madhe,rruga"Koçi Papuciu",banese private.Nr 53”
&
“Fier Ballsh BALLSH Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2,
apartament nr.3, kati.4”

NUIS J87602809S & K17710805A

*** * ***

Procedura e prokurimit: E hapur me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-09038-06-11-2024.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Bulevardi “Jakov Xoxa”, nga rrethrotullimi Ura Sheq – rrethrotullimi i Sharrës, Fier”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **36 460 465 . 09** (tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë pike zero nentë) **lekë pa TVSH**, me burim financimi nga buxheti i Bashkisë Fier, në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës:

- Per Bashkine Fier, **3 (tre) muaj** (sipas grafikut te punimeve).

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [29 Korrik 2024], [Numri 42].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këtë vlerë të ofruar, përkatësisht:

1. Operatori Ekonomik BEQIRI SHPK me NUIS J98624801V. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 26 107 305 (njëzet e gjashtë milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e pesë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori Ekonomik BESTA SHPK me NUIS J62903182B. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 20 779 952 (njëzet milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
3. Operatori Ekonomik MELA. SHPK me NUIS K62320011G. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 23 074 380 (njëzet e tre milion e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik NGRACAN 1934 SHPK me NUIS J87602809S & GLAVENICA SHPK me NUIS K17710805A. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 24 341 625 (njëzet e katër milion e treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
5. Operatori Ekonomik DESARET COMPANY SHPK me NUIS K01816001J. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 26 489 404,20 (njëzet e gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e katër pikë njëzet) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

6. Operatori Ekonomik "SARDO" SHPK me K13120402W. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 26 751 900 *(njëzet e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
7. Operatori Ekonomik SARK SHPK me NUIS K52531415H. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 32 709 201 *(tridhjetë e dy milion e shtatëqind e nëntë mijë e dyqind e një)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
8. Operatori Ekonomik Shendelli SHPK me NUIS K07924803N. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 33 631 815 *(tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
9. Operatori Ekonomik Z D R A V A SHPK me NUIS J84003411K. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 23 737 423,5 *(njëzet e tre million e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë pesë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
10. Operatori Ekonomik S I R E T A 2F SHPK me NUIS K51501008J. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 30000000 *(tridhjetë milion)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
11. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik VISCONS GROUP SHPK me NUIS L96513208E & O.E I.C.C GROUP SHPK me NUIS L51308006A. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 25 081 339,5 *(njëzet e pesë milion e tetëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e nëntë pikë pesë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
12. Operatori Ekonomik XHAŠT SHPK me NIUS K12512837I. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 29 465 278,50 *(njëzet e nëntë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë pikë pesëdhjetë)* lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- ❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **BESTA SHPK, me NUIS J62903182B**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

Operatori Ekonomik BESTA SHPK, rezulton të ketë paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët. Në zbatim të nenit 93, pika 5 të ligjit Nr.162, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, citohet se: “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

Gjithashtu, nga verifikimi i preventivit, konkretisht zëri nr.24, An 1, është pasqyruar “Ndertim Puseta **betoni** $H=4.5m$, $D=1.5m+Kapak$ ”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar “Ndertim Pusete **b/arme** $H=4.5m$, $D=1.5m+Kapak$ ”,

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 ,”Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik BESTA SHPK, me NUIS J62903182B skualifikohet.

- ❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të **B.O.E VISCONS GROUP SHPK me NUIS L96513208E & O.E I.C.C GROUP SHPK me NUIS L51308006A**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3“Kapaciteti teknik”, nuk është përmbushur pika 2.3.6, ku përcaktohet:

“Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent;

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik I.C.C GROUP SHPK, ka paraqitur në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik) ISO 9001:2015, RIG CERT, nr. certifikatë 1710AL586Q me datë përfundimi të certifikimit 19.05.2024, ndërkohë që procedura e prokurimit mbanë si datë të hapjes 12.06.2024.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 ,”Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e B.O.E VISCONS GROUP SHPK me NUIS L96513208E & O.E I.C.C GROUP SHPK me NUIS L51308006A skualifikohet.

❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **SARK SHPK me NUIS K52531415H**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, në pikën 2.2.1, përcaktohet:

”Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (2022, 2023), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabël.

...”

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE kopje të çertifikuar të bilancit vetëm për vitin 2022.

2. Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik*”, në pikën 2.3.5, përcaktohet:

”Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

“a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me

Lista e makinerive dhe pajisjeve për objektin : “Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza Bulevardi “Jakov Xoxa”, nga rrethrrrotullimi Ura Sheq – rrethrrrotullimi i Sharrës, Fier”

NR	EMËRTIMI I MAKINERISË	SASIA	STATUSI
8	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min. 10 ton	2	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Për pikën 2.3.5 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.”

Nga verifikimi i Formularit të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik "SARK" SHPK është deklaruar vetëm një "Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min. 10 ton", kur ndërkohë kërkohen 2 të tilla.

3. Gjithashtu, operatori ekonomik, në lidhje me kërkesën për sqarime të nevojshme bërë nga KVO në datë 02.07.2024, dërguar me anë të SPE-së, për saktësimin e nevojshëm në "Shtojcën 1" dhe "Shtojcën 2" për çmimin total me TVSH, nuk u përgjigj brenda afatit të përcaktuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 92 të Ligjit nr.162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 82 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik", i ndryshuar.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit", oferta e operatorit ekonomik SARK SHPK me NUIS K52531415H skualifikohet.

❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **S I R E T A 2F SHPK me NUIS K51501008J**, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se: Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3 "Aftësitë teknike dhe profesionale/Kapaciteti teknik", në pikën 2.3.5, përcaktohet:

"Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion:

....

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera ose në një nga format e njohura në legjislacionin shqiptar), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10):

- Kokore, minimumi 15 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.
- Meqënëse punimet kryhen në bulevardin kryesor të qytetit dhe fillojnë pranë një shkolle 9 vjeçare dhe vazhdojnë afër azilës, për shkak të thellësisë dhe gjerësisë së gërmimit në rrugë kërkohet rrethimi i kantierit të ndërtimit (për arsye sigurie dhe pengim fushëpamje) të përdoren new Jersey (pvc ose beton) ose barriera metalike mbrojtëse ose ekuivalente min. 45 ml.

Shënim: Për pikën 2.3.5 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.”

Sa më lart, nga verifikimi i Formularit të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik SIRETA 2F SHPK, rezulton se nuk është deklaruar asnjë informacion në lidhje me pajisjen teknike “new Jersey” (pvc ose beton) ose barriera metalike mbrojtëse ose ekuivalente min. 45 ml.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik SIRETA 2F SHPK me NUIS K51501008J skualifikohet.

❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik **XHAST SHPK me NUIS K12512837I**, KVO konstatoi se:

1. Nuk ka paraqitur *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*, në përmbushje të pikës 1/a, referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”.
2. Nuk ka paraqitur punë të ngjashme, në përmbushje të pikës 2.3.1, referuar Shtojcës 7 të DST-së.
3. Nuk është deklaruar asnjë informacion për përmbushjen e pikës 2.3.2 “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për keto punime”, gërma a), b), c), referuar Shtojcës 7 të DST-së.
4. Nuk është deklaruar asnjë informacion për përmbushjen e pikës 2.3.3, në të cilën kërkohet: “Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, një numer prej jo më pak se 15 punonjës për muajin Prill 2024.; referuar Shtojcës 7 të DST-së...”, referuar Shtojcës 7 të DST-së.
5. Nuk është deklaruar asnjë informacion për përmbushjen e pikës 2.3.4 “Liçenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”, në të cilën kërkohet:

“Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon liçence profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar. Stafi i inxhinierëve të licensuar bazohet në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e

studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” I ndryshuar.

● ***Për punimet e përgjithshme të ndërtimit shoqëria duhet të ketë liçencat e mëposhtme:***

1. NP - 1 A (*Punime gjurmimi në tokë*).
2. NP- 4 A (*Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale*).
3. NP - 7 A (*Ujësjiellësa, gazsjellësa, vepra kullimi e vaditje*).

● ***Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:***

a) NS - 18 A (*Punime Topogjeodezike ...*)”

- 6) Nuk është deklaruar asnjë informacion për përmbushjen e pikës 2.3.5 ”Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion”:

“a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates: Betoniere 500 l, Ekskavator me kovë 0.25 m³, me gomë, Ekskavator 1.0 m³ me goma (për mosdëmtimin e asfaltit gjatë levizjes së mjetit), Rul thikë, Grejder, Rul (kompresor) me vibrim, Vibrator thellësie, Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës min. 10 ton, Autobitumatriçe, Autobot, Asfaltoshtruese, Spërkatës bojë.

b) Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera ose ne nje nga format e njohura ne legjislacionin shqiptar), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.8):

- Kokore, minimumi 15 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.
- Meqënëse punimet kryhen në bulevardin kryesor të qytetit dhe fillojnë pranë një shkolle 9 vjeçare dhe vazhdojnë afër aziles, për shkak të thellësisë dhe gjerësisë së gjurmimit në rrugë kërkohet rrethimi i kantierit të ndërtimit (për arsye sigurie dhe pengim fushëpamje) të përdoren new Jersey (pvc ose beton) ose barriera metalike mbrojtese ose ekuivalente min. 45 ml.”

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik XHAŠT SHPK me NIUS K12512837I skualifikohet.

- ❖ Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik Z D R A V A SHPK me NUIS J84003411K, paraqitur në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik), KVO konstatoi se në preventiv, konkretisht zëri nr.18, An 1-H, është pasqyruar “*V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=1000 mm*”, ndërkohë që ky zë në preventivin e AK është kërkuar “*V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=1200 mm*”,

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit*”, oferta e operatorit ekonomik ZDRAVA SHPK me NUIS J84003411K skualifikohet.

* * *

Në këto kushte, si dhe bazuar në nenin 26, pika 2 dhe 6 i V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, pas përfundimit të procesit të verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik i kualifikuar i pari Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i dërgoi me anë të SPE më datë 10.07.2024 operatorit ekonomik të kualifikuar i pari MELA. SHPK me NUIS K62320011G kërkesë për paraqitjen e dokumentacionit provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumentave të tjera shoqëruese të ofertës, dokumentacioni i kërkuar në origjinal në kopje të njësuara me origjinalin, të inventarizuara brenda datës 15.07.2024, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Fier.

Operatori ekonomik MELA. SHPK me NUIS K62320011G, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si më sipër në rrugë postare, vula e së cilës mban datën 15.07.2024 nga Posta Tiranë dhe vulën me datë 16.07.2024 nga Posta Fier. Dokumentacionit i është bërë hyrje pranë Protokollit të Bashkisë Fier me nr. 7614 prot., datë 16.07.2024.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik MELA. SHPK, KVO konstatoi se:

1. Preventivi i ardhur me dokumentacionin fizik ndryshon nga preventivi i ngarkuar në SPE në emertimin e zërave dhe në vlera.
2. Vërtetim i Debisë marre nga FSHU me nr. OSHË-2024-8056152-LZ, datë 27.03.2024, përfshin faturën koherente të muajit Shkurt 2024 dhe jo të muajit Prill.
3. Nuk ka paraqitur ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent; në përmbushje të pikës 2.3.6, referuar Shtojcës 7 të DST-së.
4. Nuk ka paraqitur “*Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*”, në përmbushje të pikës 1/b, referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”.
5. Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion fizik në përmbushje të pikës 2.3.2 “*Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar per keto punime*”, pika “c”, referuar Shtojcës 7 të DST-së
6. Në përmbushje të pikës 2.3.3, referuar Shtojcës 7 të DST-së nuk ka paraqitur:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Prill 2024**
 - Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Prill 2024**
7. Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion fizik në për mbushje të pikës 2.3.5 "Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion":
- a)** Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, referuar Shtojcës 7 të DST-së
 - b)** Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera ose ne nje nga format e njohura ne legjislacionin shqiptar), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.10*):
8. Në përmbushje të pikës 2.2.1, pikës 2.3.1, pikës 2.3.2, gërma "a" dhe "b", pikën 2.3.4 dokumentacioni i përcjellë është fotokopje dhe jo origjinal ose kopje të noterizuara sipas përcaktimeve në DST.

Për sa më sipër, referuar përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST, përkatësisht:

"Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.", oferta e operatorit ekonomik MELA. SHPK me NUIS **K62320011G** skualifikohet.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **bashkimin e operatoreve ekonomike NGRACAN 1934 shpk**, me NUIS: **J87602809S & GLAVENICA shpk**, NUIS: **K17710805A**, me adrese: *"Fier Fier FIER Lagjja" Sheq i Madhe, rruga "Koçi Papuciu", banese private. Nr 53* & *"Fier Ballsh BALLSH Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4"*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej prej 24 341 625 (*njëzet e katër milion e treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Fier Lagja "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Fier , sigurimin kontrates brenda **10 (dhjetë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është

dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Armando SUBASHI